REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1123/20
Datë/Datum. 21.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **NP"TERMOKOS"Sh.a**

Për Aktivitetin me numër të Prokurimit: **TER-020-030-2.2.1**

Titulli: **MBIKQYRJA E OBJEKTIT TE RI ADMINISTRATIV DHE OBJEKTEVE PERCJELLESE TE NP"TERMOKOS"SH.A**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.N.SH "VIZION PROJECT"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

KODRA E DIELLIT BLL.IV, HY.IV, NR.20
(Adresa)

PRISHTINË — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044 261 361 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

SHKELQIM OSMANI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@vizionproject.com
(Adresa elektronike)

21.12.2020 — _____
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

N.N.SH Vizion Project PRISHTINË REPUBLIKA E KOSOVËS

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftim për Kontratë: 31.08.2020 *Afati për dorzimin e ofertave: 11.09.2020 ora 13:00* *Njoftim mbi Vendimin e AK: 30.09.2020* *Kërkesa për Rishqyrtim: 05.10.2020* *Vendimi për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim:09.10.2020* *Ankesa në OSHP: 19.10.2020* *Vendimi i panelit të OSHP-së: 13.11.2020* *Njoftim mbi Vendimin e AK: 04.12.2020* *Kërkesa për Rishqyrtim 2: 09.12.2020* *Vendim për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim: 10.12.2020*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së
Sipas Vendimit për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim si të pa bazuar të datës 09.12.2020 arsyet e AK janë:

1. Sipas komisionit të Vlersimit të tendereve pika III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional: Inxhinier i Energjisë së Efiçencës më përvoj pune 5 vjeçare, në lëmi të njëjtë numri i stafit - 1 nuk keni plotsuar këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit stafi i prezantuar nga ana juaj nuk plotëson kërkesën, qe ka qene kriter në Njoftimin për Kontratë dhe në DT.
2. Sipas komisionit të Vlersimit të tendereve pika III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJËN KUNDËR ZJARRI MË PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LEMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT - 1 nuk keni plotsuar këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit stafi i prezantuar nga ana juaj nuk plotëson kërkesën, qe ka qene kriter në Njoftimin për Kontratë dhe në DT
3. Sipas komisionit të Vlersimit të tendereve pika III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME ÇERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË PUNE 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT - 1 nuk keni plotsuar këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit stafi i prezantuar nga ana juaj nuk plotëson kërkesën, qe ka qene kriter në Njoftimin për Kontratë dhe në DT.

Kundërshtimi: Ky konstatim është shumë jo-profesional dhe në kundërshtim me çdo dispozite të legjislacionit parësor dhe dytësor për prokurim publik. AK ka shkelur pikërisht nenet 7, 59, 60, 65 dhe 69 të LPP-së dhe RRUOPP dhe poashtu AK nuk ka dhënë përgjigjie konkrete dhe të argumentuar me fakte konkrete lidhur me pretendimet tona sa i përket plotësimit të **Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe Profesional.**
Ne në Kërkesën për Rishqyrtim kemi argumentuar me fakte konkrete se i kemi plotësuar në tëresi të gjitha kërkesat siapas DT, madje duke i tejkaluar ato. Dhe, megjithë prezentimin nga ana jonë të këtyre argumenteve, AK në përgjigjen ndaj Kërkesës sonë për Rishqyrtim nuk është marrë fare me kundërargumentimin e argumenteve tona, por ka dhënë përgjigjen e njejtë si në Vendimin për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit, pa prezentuar asnjë argument që do t'i hidhte poshtë apo që do t'i kontestonte argumentet tona, të cilat dëshmojnë përgjegjshmërinë tonë si OE pjesëmarrës në këtë AP. Me këtë rast, nga ana e AK-së janë shkelur dispozitat e mëposhtne të LPP-së dhe RrUOPP-së

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1: Qëllimi i LPP-së

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 65 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik 39. Sqarimi i Tendereve Pika 39.8

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pas pranimit të **Njoftimit mbi Vendimin e AK pas Ri-vlerësimit** me datë 04.12.2020 ne si OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet prokurimi me datë 08.12.2020 kemi bërë:

Kërkesë për Rishqyrtim ku kemi dhënë argumentet dhe deshmitë tona se ne si Operator Ekonomik pjesëmarrës në këtë tender i kemi plotësuar të gjitha kërkesat ashtu siç është kerkuar në Fletat e Dhëna në DT.

Me datë 10.12.2020 kemi marrë përgjigje lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim ku AK NP "TERMOKOS" Sh.a ka refuzar Kërkesën tonë për Rishqyrtim si të pa bazuar me preteksitin se AK ka vepruar konform dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues ka dhënë sqarimet, ku thuhet se komisioni i vleresimit të ofertave ka dhënë këtë konstatim:

1. Sipas komisionit të Vlersimit të tendereve pika III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional: Inxhinier i Energjisë së Efiçencës më përvojë pune 5 vjeçare, në lëmi të njëjtë numri i stafit - 1 nuk keni plotësuar këtë kërkesë të Dosjes së

Tenderit stafi i prezantuar nga ana juaj nuk plotëson kërkesën, qe ka qene kriter në Njoftimin për Kontratë dhe në DT.

2. Sipas komisionit të Vlersimit të tendereve pika III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJËN KUNDËR ZJARRI MË PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LEMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT – 1 nuk keni plotsuar këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit stafi i prezantuar nga ana juaj nuk plotëson kërkesën, qe ka qene kriter në Njoftimin për Kontratë dhe në DT
3. Sipas komisionit të Vlersimit të tendereve pika III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional: EKSPERT I LICENSUAR DHE ME ÇERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË PUNE 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT – 1 nuk keni plotsuar këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit stafi i prezantuar nga ana juaj nuk plotëson kërkesën, qe ka qene kriter në Njoftimin për Kontratë dhe në DT.

AK ka përmendur Nenet e Ligjit të Prokurimit Publik, ku thuhet se ka vepruar sipas tyre. Mirëpo, pikërisht janë po këto Nene të LPP-së të cilat nuk janë respektuar nga ana e AK-së, edhepse nje gjë të tillë e ka kërkuar edhe OSHP në Vendimin e Panelit Shyrtues, ku ka kerkuar qe gjatë rivlerësimit të tenderit të respektohet Ligji i Prokurimit Publik.

Poashtu AK ne asnje rast nuk ka kthyer përgjigje të argumentuar lidhur me pretendimit tona të argumentuara lidhur me përgjegjshmërinë tonë si Operator Ekonomik, madje nuk ka marrë fare mundin të prezentojë asnjë kundërargument me të cilin do të kontestonte se 3 ekspertët tanë nuk i plotësojnë kërkesat e kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Me këtë rast, duam që edhe njëherë të argumentojmë se ne si OE pjesmarrës në këtë tender i kemi plotësuar të gjitha **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe Profesional ashtu siç janë kerkuar ne Dosjen e Tenderit.**

Në vijim po ju prezantojm faktet dhe argumentet tona që dëshmojnë plotësimin e kërkesave të Dosjes së Tenderit nga ana jonë si Operator Ekonomik:

Sa i përket pikave 1, 2 dhe 3 ne mendojmë se nuk qendron fare arsyetimi i AK për arsye se: ne jo vetëm që i kemi plotësuar këto kërkesa të DT, mirëpo edhe i kemi tejkaluar ato. Argumentet e prezentuara në vazhdim, të cilat i kemi prezentuar edhe në Kërkesën tonë për rishqyrtim, e dëshmojnë qartësisht se ne i kemi plotësuar kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Ne Dosjen e Tenderit tek Fletat e Dhena të Tenderit është kërkuar që:

1.

Kërkesa sipas FDT:

-INXHINIER I ENERGJISE SË EFIÇENCËS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1

Dëshmia e kërkuar dokumentare

-INXHINIER I ENERGJISE SË EFIÇENCËS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 **TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR** DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA

Për këtë pikë është kërkuar Diploma Origjinale ose e Noterizuar të cilën ne e kemi prezantuar dhe së bashku me të kemi prazantuar dhe Çertifikatën e Energjisë dhe Efiçencës, CV-në, Referencat, si dhe Kontratën e Bashkëpunimit.

Nese AK ka pasur dilema lidhur me vërtetësinë e këtyre dokumenteve apo mospërmbushjen e kërkesave të DT-së nga ana jonë si OE, ateherë ka mundur të kërkojë informata shtesë, ashtu siç e obligon Ligji i Prokurimit Publik, por një gjë të tillë nuk e ka bërë.

Si argument shtesë se inxhinieri ynë i energjisë së efiçencës i plotëson kërkesat e DT-së, më poshtë mund ta gjeni likun e personave te Çertifikuar per Auditim të Energjisë së Efiqencës në territorin e Kosovës, ku gjendet edhe emri i inxhinerit tonë:

https://mzhe-ks.net/sq/auditoret-e-energjise-310#.X8-XithKiUk

2.

Kërkesa sipas FDT:

EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR MBROJTJE KUNDËR ZJARRI ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR MBROJTJE KUNDËR ZJARRI ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 **TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR** DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA

Për këtë pikë është kërkuar Diploma Origjinale ose e Noterizuar, të cilën ne e kemi prezantuar dhe së bashku me të kemi prezantuar dhe Çertifikatën e Mbrojtjes Kundër Zjarrit, CV-në, Referencat, si dhe Kontratën e Bashkëpunimit.

Nese AK ka pasur dilema lidhur me vërtetësinë e ketyre dokumenteve apo mospërmbushjen e kërkesave të DT-së nga ana jonë si OE, atëherë ka mundur të kërkoj informata shtesë, ashtu siç e obligon Ligji për Prokurim Publik, por një gjë të tillë nuk e ka bërë.

3.

Kërkesa sipas FDT:

EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

EKSPERT I LICENSUAR DHE ME CERTIFIKATË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS ME PËRVOJË 5 VJEÇARE, NË LËMI TË NJËJTË NUMRI I STAFIT -1 **TE PREZANTOHET DIPLOMA ORIGJINAL OSE E NOTERIZUAR** DHE DESHMI PER PRVOJEN E PUNES NGA TRUSTI PENSIONAL OSE DESHMI TJERA

Për këtë pikë është kërkuar Diploma Origjinale ose e Noterizuar, të cilën ne e kemi prezantuar dhe së bashku me të kemi prezantuar dhe Licencën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, CV-në, Referencat, si dhe Kontratën e Bashkëpunimit.

Nese AK ka pasur dilema lidhur me vërtetësinë e këtyre dokumenteve apo mospërmbushjen e kërkesave të DT nga ana jonë si OE, atëherë ka mundur të kërkoj informata shtesë, ashtu siç e obligon Ligji për Prokurim Publik, por një gjë të tillë nuk e ka bërë.

Si argument shtesë se eksperti ynë i licencuar dhe me çertifikatë për ndikimin në mjedis, i plotëson kërkesat e DT-së, më poshtë mund ta gjeni likun e personave te Çertifikuar per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në territorin e Kosovës, ku gjendet edhe emri i ekspertit tonë:

https://mmph.rks-gov.net/licensa/299/lista-e-personave-juridik-te-licencuar-per-hartimin-e-raporteve-te-vnm-se

Për ekspertet e prezantuar si më lartë ne në Kërkesën për Rishqyrtim kemi ofruar fakte dhe dëshmi të argumentuara, siç janë Listat e Personave të Licencuar dhe Çertifikuar nga autoritet kredibile në Kosovë, të cilat i kemi bashkangjitur në Kërkesën për Rishqyrtim.

Ekpertet tanë ndodhen në këto lista dhe fare lehtë mund të verifikohen edhe duke klikuar në web-faqet e Institucioneve që mirren me lëshimin e këtyre dokumenteve dhe aty mund të gjeni emrat e tyre.

AK **NP"TERMOKOS"Sh.a** më këtë rast ka vepruar në kundërshtim të plote me këto nene të LPP-së

Neni 1: Qëllimi i LPP

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, proceduarat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përbushen nga personat, operatoret ekonomik, ndërmarrjet, autorietet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 7: Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti Kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veproj në mënyrë transparente

Kundërshtimi: AK- ka vepruar në kundërshtim të plote më këtë nen, pasi qe shihet qartë se ne si OE i kemi plotësuar të gjitha - **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe Profesional ashtu siç është kerkuar në DT.**
Gjithashtu AK-ja nuk ka respektuar **Nenin 69,** si dhe dispozitat e **Nenit 59 të LPP-së** i cili parasheh qartë se: "*Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara ne Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit*".

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk ka respektuar edhe **Nenin 72** të LPP-së dhe dispozitat e **Nenit 39 pika 39.8 të RRUOPP-së** ku thuhet: AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik.
Nese AK ka pasur ndonje dilemë lidhur me vërtetësinë e dokumenteve apo mospermbushjen e **Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe Profesional ashtu siç është kerkuar në DT** atëherë fare lehtë ka mundur të përdorë Nenet e permendura me lartë, mirëpo një gjë të tillë nuk e ka bërë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, ankesa e OE **N.N.SH "VIZION PROJECT"** si e bazuar
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 2,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftim për Vendimin e AK-së"*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
e) *Nje kopje të "Kërkesës për Rishqyrtim"*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*